

32003L0006

Direktivë 2003/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 28 Janar 2003, "Për tregtimin me informacionet e privileguara dhe manipulimin e tregut (abuzimi me tregun)"

Gazeta Zyrtare L 096, 12/04/2003 F. 0016 - 0025

Direktiva 2003/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 28 Janar 2003, "Për tregtimin me informacionet e privileguara dhe manipulimin e tregut (abuzimi me tregun)"

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe në veçanti Nenin 95 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit ⁽¹⁾,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social ⁽²⁾,

Duke pasur parasysh opinionin e Bankës Qendrore Evropiane ⁽³⁾,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 251, paragrafi 4,

Meqë:

1. Një treg i vetëm i unifikuar i shërbimeve financiare është thelbësor për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në Komunitet.

2 Një treg financiar i integruar dhe efikas kërkon integritet të tregut. Funkzionimi normal i tregjeve të titujve dhe besimi i publikut në to përbëjnë kushtet paraprake për rritjen ekonomike dhe mirëqenien. Abuzimi me tregun dëmton integritetin e tregjeve financiare dhe besimin e publikut në tituj dhe derivate.

3. Komunikata e Komisionit e 11 Majit 1999 e quajtur "Implementimi i kuadrit të tregjeve financiare: plani i veprimit" identifikon një seri veprimesh të nevojshme për të plotësuar shërbimet financiare të tregut të vetëm. Këshilli Evropian i Lisbonës i prillit 2000 kërkoj zbatimin e atij plani veprimi deri në vitin 2005. Plani i Veprimit thekson nevojën për të hartuar një direktivë kundra manipulimit të tregut.

4. Në takimin e tij të 17 Korrikut 2000, Këshilli ngriti Komitetin e të Urtëve për rregullimin e tregjeve evropiane të titujve. Në raportin e tij përfundimtar, Komiteti i të Urtëve propozoi prezantimin e disa teknikave të reja legjislative bazuar në një qasje me katër nivele, konkretisht parimet kuadër, masat zbatuese, bashkëpunimi dhe zbatimi. Niveli 1, direktiva duhet ta përkufizojë gjerësisht veten në parimet e përgjithshme "kuadër", ndërsa Niveli 2 duhet të përmbajë masa teknike zbatuese për t'u miratuar nga Komisioni me ndihmën e një komiteti.

5. Rezoluta e miratuar nga Këshilli Evropian i Stokholmit i Marsit 2001 miratoi raportin përfundimtar të Komitetit të të Urtëve dhe qasjen e propozuar me katër nivele, për ta bërë më efikas dhe transparent procesin rregullues për legjislacionin komunitar për titujt.

6. Rezoluta e Parlamentit Evropian e 5 Shkurtit 2002 mbi zbatimin e legjislacionit të shërbimeve financiare miratoi edhe raportin e Komitetit të të Urtëve, në bazë të deklaratës solemne të mbajtur para Parlamentit në po atë datë nga Komisioni, si dhe të shkresës së 2 tetorit 2001 që Komisioneri i Tregut

të Brendshëm i drejtonte Kryetarit të Komitetit Parlamentar për Çështjet Ekonomike dhe Monetare në lidhje me garancitë për rolin e Parlamentit Evropian në këtë proces.

7. Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj direktive duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE të 28 Qershorit 1999, që përcakton procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i delegohen Komisionit ⁽⁵⁾.

8. Sipas Këshillit Evropian të Stokholmit, masat zbatuese të Nivelit 2 duhet të përdoren më shpesh për të siguruar që dispozitat teknike të mbahen të përditësuara me tregun dhe me zhvillimet mbikëqyrëse dhe që të vendosen afate kohore për të gjitha fazat e Nivelit 2.

9. Parlamentit Evropian duhet t'i jepet një periudhë prej tre muajsh kohë nga transmetimi i parë i projektligjit për masat zbatuese, në mënyrë që ai të mund t'i shqyrtojë masat dhe të japë mendimin e tij. Megjithatë, në raste urgjente dhe të justifikuara, kjo periudhë mund të shkurtohet. Nëse brenda kësaj periudhe miratohet ndonjë rezolutë nga Parlamenti Evropian, Komisioni duhet të ri-shqyrtojë projekt masat.

10. Zhvillimet e reja financiare dhe teknike përmirësojnë incentivat, mjetet dhe mundësitë për abuzimet në treg: me anë të produkteve të reja, teknologjive të reja, rritjes së veprimtarisë ndërkuftare dhe me anë të internetit.

11. Kuadri ligjor komunitar ekzistues për mbrojtjen e integritetit të tregut është i paplotë. Kërkesat ligjore ndryshojnë nga një shtet anëtar në tjetrin, duke bërë që aktorët në sektorin e ekonomisë shpesh të jenë të paqartë mbi konceptet, përkufizimet dhe zbatimin. Në disa shtete anëtare nuk ka legjislacionin që trajton çështjet e manipulimit të çmimeve dhe shpërndarjen e informacionit çorientues.

12. Abuzimi me tregun përbëhet nga abuzimi me informacionet e privileguara dhe manipulimi i tregut. Objektiva e legjislacionit kundër abuzimit me informacionet e privileguara është e njëjtë me legjislacionin kundër manipulimit të tregut: për të siguruar integritetin e tregjeve financiare të komunitetit dhe për të rritur besimin e investitorëve në këto tregje. Kështu që këshillohet të miratohen rregulla të kombinuara për të luftuar si abuzimet me informacionet e privileguara ashtu edhe manipulimet me tregun. Një direktivë e vetme për të gjithë komunitetin do të siguronte të njëjtin kuadër për ndarjen e përgjegjësive, zbatimin dhe bashkëpunimin.

13. Duke pasur parasysh ndryshimet në tregjet financiare dhe në legjislacionin komunitar që nga miratimi i Direktivës së Këshillit 89/592/KEE të 13 nëntorit 1989 që koordinon rregulloret për abuzimet me informacionin e privileguar ⁽⁶⁾, ajo direktivë tashmë duhet të zëvendësohet për të siguruar konsistencë me legjislacionin kundër manipulimit të tregut. Gjithashtu, nevojitet një direktivë e re për të shmangur boshllëqet e legjislacionit komunitar, të cilat mund të keqpërdoren dhe të minojnë besimin e publikut dhe rrjedhimisht edhe funksionimin normal të tregjeve.

14. Kjo direktivë trajton shqetësimet e shprehura nga shtetet anëtare pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001, në lidhje me luftën kundër financimit të veprimtarive terroriste.

15. Abuzimet me informacione të privileguara dhe manipulimi i tregut pengojnë transparencën e plotë dhe të duhur të tregut, që është kusht i domosdoshëm për tregtimin e të gjithë aktorëve të ekonomisë në tregjet financiare të integruara.

16. Informacioni i privileguar është çdo lloj informacioni i një natyre të saktë që nuk është bërë publik dhe që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë emetues të instrumenteve financiare

ose një ose më shumë instrumente financiare. Informacioni që mund të ketë një efekt domethënës në zhvillimin dhe formimin e çmimeve në një treg të rregulluar si të tillë, mund të konsiderohet si informacion që nuk lidhet drejtpërdrejt me një ose më shumë emetues të instrumenteve financiare ose një ose më shumë instrumente financiare derivative të lidhur.

17. Në lidhje me abuzimet me informacione të privilegjuara, vëmendje e veçantë u kushtohet rasteve kur informacioni i privilegjuar nuk vjen nga një profesion apo funksion por nga veprimtari kriminale, përgatitja ose ekzekutimi i të cilave mund të ketë një efekt domethënës për çmimet e një ose më shumë instrumenteve financiare ose për formimin e çmimeve në një treg të rregulluar si të tillë.

18. Përdorimi i informacionit të privilegjuar mund të ketë lidhje me blerjen ose shitjen e instrumenteve financiare nga një person i cili është në dijeni, ose duhet të ketë pasur dijeni se informacioni që zotëronte është informacion i privilegjuar. Në këtë aspekt, autoritetet kompetente duhet të marrin në konsideratë se një person normal dhe i arsyeshëm ka dijeni ose duhet të ketë dijeni në ato rrethana. Për më tepër, vetë fakti se personat që përbëjnë tregun, organet e autorizuara për të vepruar si palë të tjera, ose personat e autorizuar për të zbatuar urdhrat për llogari të palëve të treta me informacion të privilegjuar, në dy rastet e para, për t'ju përmbajtur objektivit për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre legjitime për blerjen ose shitjen e instrumenteve financiare ose, në rastin e fundit, për të zbatuar siç duhet një urdhër që në vetvete nuk duhet të konsiderohet se përbën përdorim të këtij lloji informacioni të privilegjuar.

19. Shtetet anëtare duhet të ndjekin praktikën e njohur si "drejtimi frontal", duke përfshirë "drejtimin frontal" edhe për derivatet e mallrave me përdorim të gjerë, çka përbën abuzim me tregun sipas përkufizimeve të kësaj Direktive.

20. Një person i cili bën transaksione ose emeton urdhra për tregtim, të cilat janë elementë përbërës të manipulimit të tregut, mund të vërtetojë se arsyet e tij për të hyrë në të tilla transaksione ose për të emetuar urdhra të tillë për tregtim ishin të ligjshme dhe se transaksionet dhe urdhrat për tregtim ishin në përputhje me praktikën e pranuar në tregun e rregulluar në fjalë. Sanksioni mund të vendoset edhe nëse autoriteti kompetent vërteton se ekzistonte një arsye tjetër e jashtëligjshme pas këtyre transaksioneve apo urdhrave për tregtim.

21. Autoriteti kompetent mund të japë udhëzime për çështjet e mbuluara nga kjo Direktivë, p.sh. përkufizimi i informacionit të privilegjuar në lidhje me derivatet e mallrave të përdorimit të gjerë ose zbatimin e përkufizimit të praktikave të pranuar të tregut, në lidhje me përkufizimin e manipulimit të tregut. Ky udhëzim duhet të jetë në përputhje me dispozitat e direktivës dhe masat zbatuese të miratuara në përputhje me procedurën e modifikimit.

22. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zgjedhin mënyrën më të përshtatshme për të rregulluar personat që prodhojnë ose shpërndajnë kërkime në lidhje me instrumentet financiare ose emetuesit e instrumenteve financiare apo personat që prodhojnë ose shpërndajnë informacione të tjera që rekomandojnë ose sugjerojnë strategjinë e investimeve, duke përfshirë edhe mekanizmat e duhura për vetë-rregullim, të cilat duhet t'i njoftohen Komisionit.

23. Kur emetuesit afishojnë informacion të privilegjuar në faqet e tyre të internetit, kjo duhet të bëhet në përputhje me rregullat për transferimin e të dhënave personale në vende të treta, siç përcaktohet në Direktivën 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 24 tetorit 1995 mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e këtyre të dhënave (7).

24. Bërja publike me shpejtësi dhe drejtësi e informacionit, rrit integritetin e tregut, ndërsa publikimi i informacionit në mënyrë selektive nga emetuesit, mund të çojë në humbjen e besimit të investitorëve në integritetin e tregjeve financiare. Aktorët ekonomikë profesionistë duhet të kontribuojnë në integritetin e tregut me anë të mjeteve të ndryshme. Këto masa mund të përfshijnë, për shembull, krijimin e "listave gri", aplikimin e "tregtisë dritare" për kategori të ndjeshme të personelit, zbatimin e kodeve të brendshme të etikës dhe krijimin e "mureve kineze". Këto masa parandaluese mund të kontribuojnë në luftën kundër abuzimit me tregun vetëm nëse ato zbatohen me vendosmëri dhe janë të kontrolluara siç duhet. Me kontroll të duhur të zbatimit nënkuptojmë për shembull caktimin e oficerëve të pajtueshmërisë brenda organeve në fjalë dhe kontrole periodike të kryera nga auditorë të pavarur.

25. Metodat moderne të komunikimit bëjnë të mundur që profesionistët e tregut financiar dhe investitorët privatë të kenë më shumë akses të barabartë në informacionin financiar, por kjo rrit edhe rrezikun e përhapjes së informacioneve të rreme apo çorientuese.

26. Një tjetër masë parandaluese kundër abuzimit me tregun është edhe vendosja e një transparence më të madhe të transaksioneve të kryera nga persona me përgjegjësi drejtuese brenda stafit të emetuesve dhe, kur është e zbatueshme, edhe nga persona të lidhur ngushtë me ta. Edhe publikimi i këtyre transaksioneve të paktën në baza individuale mund të jetë një burim shumë i vlefshëm i informacionit për investitorët.

27. Operatorët e tregut duhet të kontribuojnë për parandalimin e abuzimit me tregun dhe të miratojnë dispozitat strukturore që synojnë parandalimin dhe zbulimin e praktikave të manipulimit të tregut. Këto dispozita mund të përfshijnë kërkesat në lidhje me transparencën e transaksioneve të përfunduara, zbulimin e plotë të marrëveshjeve të rregullimit të çmimit, një sistem të drejtë të çiftimit rendor, futjen e një skeme efikase për zbulimin e rendit jo tipik, skema reference të instrumenteve financiare që janë mjaftueshëm të qëndrueshme për përcaktimin e çmimit dhe qartësinë e rregullave për pezullimin e transaksioneve.

28. Kjo direktivë duhet të interpretohet dhe të zbatohet nga shtetet anëtare në përputhje me kërkesat për rregullimin efikas, me qëllim mbrojtjen e interesave të mbajtësve të titujve të transferueshëm që kanë të drejtë vote në një shoqëri (ose që mund të mbartin këto të drejta si pasojë e ushtrimit të të drejtave apo shndërrimit të tyre), kur shoqëria është objekt i një tenderi publik apo është propozuar për ndryshim kontrolli. Në veçanti, kjo direktivë në asnjë mënyrë nuk parandalon një shtet anëtar të ketë apo të vendosë masa të tilla, ashtu siç e shikon të arsyeshme për këto qëllime.

29. Të pasurit akses në informacionin e privilegjuar në lidhje me një kompani tjetër dhe përdorimi i tij për një tender publik me qëllim që të fitojë kontrollin e asaj kompanie apo propozimi për një bashkim me atë kompani nuk përbën në vetvete abuzim me informacionet e privilegjuara.

30. Meqenëse blerja apo shitja e instrumenteve financiare domosdoshmërisht parashikon që personi i cili ndërmerr ndonjë nga këto veprime të marrë një vendim paraprak për blerjen apo shitjen e tyre, kjo blerje apo shitje nuk konsiderohet në vetvete si përdorim i informacionit të privilegjuar.

31. Kërkimet dhe vlerësimet e zhvilluara nga të dhënat publike nuk duhet të konsiderohen si informacion i privilegjuar dhe, për këtë arsye, çdo transaksion i kryer mbi bazën e këtyre kërkimeve apo vlerësimeve nuk përbën në vetvete abuzim me informacionin e privilegjuar brenda kuptimit të kësaj Direktive.

32. Shtetet anëtare dhe Sistemi Evropian i Bankave Qëndrore, bankat qëndrore kombëtare ose çdo organ tjetër i caktuar zyrtarisht, apo çdo person që vepron në emër të tyre, nuk duhet të kufizohen të zbatojnë politikat monetare, kursin e këmbimit apo administrimin e borxhit publik.

33. Stabilizimi i instrumenteve financiare ose tregtimi në aksionet vetjake në programet e riblerjes, mund të jetë i ligjshëm në rrethana të caktuara, për arsye ekonomike, dhe rrjedhimisht, nuk duhet të konsiderohet në vetvete si abuzim me tregun. Duhet të krijohen standarde të përbashkëta për dhënien e udhëzimeve praktike.

34. Qëllimi i shtrirjes së tregjeve financiare, ndryshimi i shpejtë dhe gama e produkteve dhe zhvillimeve të reja kërkojnë një aplikim të gjerë të kësaj direktive për instrumentet financiare dhe teknikat e përfshira, për të garantuar integritetin e tregjeve financiare komunitare.

35. Krijimi i kushteve të barabarta në tregjet financiare komunitare kërkon një aplikim të gjerë gjeografik të dispozitave të mbuluara nga kjo direktivë. Për sa i përket instrumenteve derivative jo të pranuar për tregtim por që janë brenda fushës së zbatimit të kësaj direktive, çdo shtet anëtar duhet të jetë kompetent për veprimet sanksionuese të ndërmarra brenda apo jashtë territorit të tij, çka përfshin garantimin e instrumenteve financiare të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar që gjendet apo që vepron brenda territorit të tij ose për të cilin është bërë një kërkesë për pranim për tregtim në një treg të tillë të rregulluar. Çdo shtet anëtar duhet të jetë kompetent edhe për të sanksionuar veprime të kryera brenda territorit të tij, që kanë të bëjnë me instrumentet financiare të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në një shtet anëtar ose për të cilin është paraqitur një kërkesë për pranim për tregtim në një treg të tillë.

36. Nëse në shtetet anëtare ka shumëllojshmëri autoritetesh kompetente me përgjegjësi të ndryshme, kjo mund të krijojë konfuzion mes aktorëve ekonomikë. Ndaj duhet të caktohet një autoritet i vetëm kompetent në çdo shtet anëtar, për të marrë të paktën përgjegjësinë përfundimtare për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me dispozitat e miratuara në zbatim të kësaj direktive, si dhe për bashkëpunimin ndërkombëtar. Ky autoritet duhet të jetë i natyrës administrative, që garanton pavarësinë e tij nga aktorët ekonomikë dhe që shmang konfliktet e interesit. Në përputhje me legjislacionin e brendshëm, shtetet anëtare duhet të sigurojnë financimin e duhur të autoritetit kompetent. Ky autoritet duhet të ketë elementët e duhur të konsultimit në lidhje me ndryshimet e mundshme në legjislacionin e brendshëm, si p.sh. si një komitet konsultativ të përbërë nga përfaqësues të emetuesëve, ofrues të shërbimeve financiare dhe konsumatorë, për të qenë plotësisht i informuar mbi pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre.

37. Një set i përbashkët i mjeteve dhe kompetencave efikase minimale të autoritetit kompetent në çdo shtet anëtar, do të garantonte efektshmërinë e mbikëqyrjes. Edhe ndërmarrjet e tregut dhe të gjithë aktorët ekonomikë duhet të kontribuojnë, në nivelin e tyre, për integritetin e tregut. Në këtë kuptim, caktimi i një autoriteti të vetëm kompetent për abuzimet në treg nuk përjashton lidhje bashkëpunimi ose delegime nën përgjegjësinë e autoritetit kompetent, mes atij autoriteti dhe ndërmarrjeve në treg, me synim garantimin e një mbikëqyrjeje efikase të pajtueshmërisë me dispozitat e miratuara në zbatim të kësaj Direktive.

38. Për t'u siguruar se kuadri ligjor komunitar kundër abuzimit në treg është i mjaftueshëm, çdo shkelje e ndalimeve apo kërkesave të përcaktuara sipas kësaj direktive, do duhet të zbulohet dhe të sanksionohet menjëherë. Për këtë qëllim, sanksionet duhet të jenë shtrënguese dhe proporcionale mjaftueshëm, në varësi të shkallës së shkeljes dhe të fitimeve të realizuara, dhe duhet të zbatohet rregullisht.

39. Shtetet anëtare duhet të jenë vigjilente në përcaktimin e masave dhe sanksioneve administrative, deri sa të sigurojnë një shkallë njëtrajtshmërie me rregullat e një shteti tjetër anëtar.

40. Veprimtaritë ndërkufitare në rritje kërkojnë përmirësim të bashkëpunimit dhe një set gjithëpërfshirës dispozitash për shkëmbimin e informacionit mes autoriteteve kompetente kombëtare. Organizimi i kompetencave mbikëqyrëse dhe hetuese në secilin shtet anëtar nuk duhet të pengojë bashkëpunimin mes autoriteteve kompetente kombëtare.

41. Meqenëse objektivi i kësaj mase të propozuar, konkretisht parandalimi i abuzimeve në treg, në formën e abuzimit me informacionet e privileguara dhe manipulimit të tregut, nuk mund të arrihet plotësisht kur shtetet anëtare veprojnë në mënyrë të njëanshme dhe, për shkak të shkallës dhe efektivitetit të këtyre masave, mund të arrihet më mirë në nivel Komuniteti, ky i fundit mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, sipas nenit 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij objektivi.

42. Për të pasur në konsideratë zhvillimet e reja në tregjet financiare, mund të jenë të nevojshme, herë pas here, udhëzime teknike dhe masa zbatuese për normat e përcaktuara në këtë direktivë. Komisioni duhet të jetë i autorizuar për të miratuar masa zbatuese, me kusht që këto masa të mos modifikojnë elementet thelbësorë të kësaj direktive dhe që Komisioni të veprojë në përputhje me parimet e parashikuara në këtë direktivë, pasi të jetë këshilluar me Komitetin Evropian për Titujt, të krijuar me Vendimin e Komisionit 2001/528/KE⁽⁸⁾.

43. Për ushtrimin e kompetencave zbatuese, në përputhje me këtë direktivë, Komisioni duhet të respektojë parimet e mëposhtme:

- nevoja për të siguruar besimin në tregjet financiare mes investitorëve, duke promovuar standarde të larta transparence në tregjet financiare,
- nevoja për t'u mundësuar investitorëve një gamë të gjerë investimesh konkurruese dhe një nivel zbulimi dhe mbrojtjeje të informacionit në përshtatje me rrethanat e tyre,
- nevoja për t'u siguruar që autoritetet e pavarura rregullatorë të zbatojnë rregullisht rregullat, veçanërisht në lidhje me luftën kundër krimit ekonomik,
- nevoja për një nivel të lartë transparence dhe këshillimi me të gjithë pjesëmarrësit në treg dhe me Parlamentin Evropian e Këshillin,
- nevoja për të nxitur risitë në tregjet financiare, nëse ato do të jenë dinamike dhe efikase,
- nevoja për të siguruar integritetin e tregut me anë të monitorimit të ngushtë dhe reagues ndaj risive financiare,
- rëndësia e uljes së kostos dhe rritjes së aksesit në kapital,
- bilanci i kostove dhe përfitimeve për pjesëmarrësit në treg në terma afat-gjatë (duke përfshirë edhe bizneset e vogla dhe të mesme dhe investitorët e vegjël) për çdo masë zbatuese,
- nevoja për të nxitur konkurrencën ndërkombëtare të tregjeve financiare të BE-së, pa cenuar rritjen aq të nevojshme të bashkëpunimit ndërkombëtar,

- nevoja për të arritur kushte të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit në treg, duke vendosur rregullore për të gjithë territorin e BE-së, sa herë që duhet,
- nevoja për të respektuar dallimet mes tregjeve financiare kombëtare, kur ato nuk cenojnë padrejtësisht koherencën e tregut të vetëm,
- nevoja për të siguruar koherencë me ligje të tjera komunitare në këtë fushë, meqenëse pabarazitë në informim dhe mungesa e transparencës mund të rrezikojnë funksionimin e tregjeve dhe mbi të gjitha të dëmtojnë konsumatorët dhe investitorët e veçjël.

44. Kjo direktivë respekton të drejtat themelore dhe parimet e njohura sidomos nga Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, dhe sidomos nga neni 11 i saj dhe neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë drejtim, kjo direktivë nuk parandalon kurrsesi shtetet anëtare të aplikojnë rregullat e tyre kushtetuese në lidhje me lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes në media,

MIRATOJNË KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Direktive:

1. "Informacion i privilegjuar" është informacioni i një natyre specifike që nuk është bërë publik dhe që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë emetues të instrumenteve financiare ose një ose më shumë instrumente financiare, i cili nëse do të ishte bërë publik, do të kishte pasur ndikim të konsiderueshëm në çmimet e atyre instrumenteve financiare ose në çmimin e instrumenteve financiare derivative.

Në lidhje me derivativët e mallrave me përdorim të gjerë, "informacion i privilegjuar" është informacioni i një natyre specifike që nuk është bërë publik dhe që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë nga këto derivativë dhe që pritet të merret nga përdoruesit e tregjeve ku tregtohen derivativë të tillë, në përputhje me praktikatat e miratuara për këto tregje.

Për persona që janë përgjegjës për zbatimin e urdhrave për instrumentet financiare "informacion i privilegjuar" është edhe informacioni i transmetuar nga një klient dhe që ka lidhje me urdhrat e mbetur pezull të klientit, i cili është i një natyre specifike dhe lidhet direkt ose tërthorazi me një ose më shumë emetues të instrumenteve financiare ose me një ose më shumë instrumente financiare dhe që do të kishte një ndikim të konsiderueshëm në çmimet e këtyre instrumenteve financiare ose në çmimin e instrumenteve financiare derivative, nëse do të bëhej publik.

2. "Manipulim i tregut" është:

(a) transaksione ose urdhra për tregtim:

- që japin, ose ka të ngjarë të japin, sinjale të rreme ose çorientuese për ofertën, kërkesën ose çmimin e instrumenteve financiare, ose

- që sigurojnë, nga një person/persona që veprojnë në bashkëpunim, çmimin e një ose disa instrumenteve financiare në një nivel jonormal ose artificial,

përveçse kur personi, i cili ka hyrë në transaksion ose ka emetuar urdhra për tregtim, vërteton se arsyet e tij për këtë veprim janë legjitime dhe se këto transaksione apo urdhra për tregtim përputhen me praktikën e pranuar të tregut për tregun e rregulluar në fjalë;

(b) transaksione apo urdhra për tregtim, që përfshijnë pajisje fiktive apo çdo formë tjetër mashtrimi apo sajimi;

(c) shpërndarjen e informacionit nëpërmjet medias, duke përfshirë internetin ose çdo mjet tjetër, që përçon, ose ka të ngjarë të përçojë sinjale të rreme ose çorientuese për instrumentet financiare, duke përfshirë edhe përhapjen e thashethemeve dhe lajmeve të rreme ose çorientuese, kur personi që shpërndan informacionin është në dijeni, ose duhet të jetë në dijeni se informacioni është i rremë ose çorientues. Në rastin e gazetarëve, kur janë duke ushtruar profesionin e tyre, një shpërndarje e tillë e informacionit duhet vlerësuar, pa cenuar nenin 11, duke marrë në konsideratë rregullat që rregullojnë profesionin e tyre, përveçse kur këta persona përfitojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një avantazh apo përfitim nga shpërndarja e informacionit në fjalë.

Në veçanti, rastet e mëposhtme rrjedhin nga përkufizimi bazë i parashikuar në pikat (a), (b) dhe (c) më sipër:

- sjellja e një personi/personave që veprojnë në bashkëpunim, për të siguruar një pozitë dominuese mbi ofertën ose kërkesën për një instrument financiar, me qëllim caktimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çmimeve të blerjes ose shitjes ose krijimin e kushteve të tjera të padrejta të tregut,

- blerja apo shitja e instrumenteve financiare në momentin e mbylljes së tregut duke çorientuar investitorët që veprojnë në bazë të çmimeve të mbylljes,

- përfitimi nga aksesit rastësor apo i rregullt në median tradicionale apo elektronike duke shprehur një opinion në lidhje me një instrument financiar (ose indirekt për emetuesin e tij), kur është pozicionuar më parë për atë instrument financiar dhe rrjedhimisht ka përfituar më pas nga ndikimi i opinionëve të shprehura mbi çmimin e këtij instrumenti, pa e bërë njëkohësisht publik, në një mënyrë të përshtatshme dhe efikase, këtë konflikt interesi.

Përkufizimet e manipulimit të tregut duhet të përshtaten në mënyrë të tillë që të përfshijnë edhe modele të reja veprimtarie që në praktikë përbëjnë manipulim të tregut.

3. "Instrument financiar" është:

- tituj të transferueshëm, sipas përkufizimit të tyre në Direktivën e Këshillit 93/22 /KEE të 10 Majit 1993 për shërbimet e investimeve në fushën e titujve⁽⁹⁾,

- kuotat në sipërmarrjet e investimeve kolektive,

- instrumente të tregut monetar,

- kontratat financiare të së ardhmes, duke përfshirë instrumentet e barasvlershëm të ofruar në të holla (future contracts),

- marrëveshjet paraprake të normave të interesit (forward contracts),

- normat interesit, këmbimet në valutë dhe swaps mbi aksionet,

- opsionet për blerjen ose shitjen e çdo instrumenti që bën pjesë në këto kategori, duke përfshirë instrumentet e barasvlershme të ofruar në të holla (options). Kjo kategori përfshin veçanërisht opsione në valutë dhe në norma interesi,

- derivativët mbi mallrat me përdorim të gjerë,

- çdo instrument tjetër i pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në një shtet anëtar ose për të cilin është bërë kërkesë për praninë për tregtim në një treg të tillë.

4. "Treg i rregulluar" është një treg sipas përkufizimit në nenin 1, paragrafi 13 të Direktivës 93/22/KEE.

5. "Praktikat e pranuar të tregut" janë praktikat e pritshme në masë të arsyeshme në një apo më shumë tregje financiare dhe që pranohen nga autoriteti kompetent, në përputhje me udhëzimet e miratuara nga Komisioni, sipas procedurës së parashikuar në nenin 17, paragrafi 2.

6. "Person" është çdo person fizik ose juridik.

7. "Autoritet kompetent" është autoriteti kompetent i caktuar në përputhje me nenin 11.

Që të merren parasysh zhvillimet në tregjet financiare dhe që të sigurohet zbatimi i njëtrajtshëm i kësaj direktive, Komisioni, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 17, paragrafi 2, miraton masat zbatuese në lidhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 2

1. Shtetet anëtare e ndalojnë çdo person të përmendur në nënparagrafin e dytë, i cili disponon informacion të privilegjuar, që ta përdorë këtë informacion për të blerë ose shitur, ose për të tentuar të blejë ose të shesë për llogari të vet ose për llogari të një pale të tretë, qoftë drejtpërdrejtë ose tërthorazi, instrumentet financiare me të cilat lidhet informacioni.

Nënparagrafi i parë zbatohet për çdo person që e disponon këtë informacion:

(a) në saj të anëtarësimit të tij në organe administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit; ose

(b) në saj të pjesëmarrjes në kapitalin e emetuesit; ose

(c) në saj të aksesit në informacion nëpërmjet ushtrimit të detyrave të tij funksionale ose profesionale; ose

(d) në saj të veprimtarisë së tij kriminale.

2. Kur personi i përmendur në paragrafin 1, është person juridik, ndalimi i parashikuar në atë paragraf do të zbatohet edhe për personat fizikë që marrin vendimin të kryejnë transaksione për llogari të personit juridik në fjalë.

3. Ky nen nuk zbatohet për transaksione të kryera për shkarkimin nga detyrimi që ka lindur për të blerë ose shitur instrumente financiare, kur ky detyrim rrjedh nga një marrëveshje e lidhur përpara se personi në fjalë të merrte informacionin e privilegjuar.

Neni 3

Shtetet anëtare ndalojnë çdo person që i nënshtrohet ndalimit të parashikuar në nenin 2, që:

(a) t'i japë informacion të privilegjuar ndonjë personi tjetër, përveç rastit kur informacioni jepet në funksion të ushtrimit të profesionit ose detyrës së tij;

(b) të rekomandojë ose të nxisë një person tjetër, në bazë të informacionit të privilegjuar, për të blerë ose shitur instrumente financiare me të cilat lidhet informacioni.

Neni 4

Shtetet anëtare sigurojnë që nenet 2 dhe 3 të zbatohen edhe për çdo person, përveç personave të përmendur në këto nene, i cili disponon informacion të privilegjuar, kur ai person është në dijeni, ose duhet të jetë në dijeni, se bëhet fjalë për informacion të privilegjuar.

Neni 5

Shtetet Anëtare ndalojnë çdo person që të përfshihet në manipulimin e tregut.

Neni 6

1. Shtetet anëtare sigurojnë që emetuesit e instrumenteve financiarë të informojnë sa më shpejtë të jetë e mundur publikun për informacionin e privilegjuar që lidhet drejtpërdrejt me emetuesit në fjalë.

Pa cenuar çdo lloj mase të marrë në përputhje me dispozitat e nënparagrafit të parë, shtetet anëtare sigurojnë që emetuesit të afishojnë në faqet e tyre të internetit, për një periudhë të përshtatshme, të gjithë informacionin e privilegjuar që duhet ta bëjnë publik.

2. Një emetues mundet që, nën përgjegjësinë e tij të plotë, të vonojë publikimin e informacionit të privilegjuar sipas parashikimit në paragrafin 1, për të mos cenuar interesat e tij legjitime, me kusht që ky mosveprim i tij të mos çorientoj publikun dhe me kusht që emetuesi të mund të sigurojë konfidencialitetin e atij informacioni. Shtetet anëtare mund të kërkojnë që emetuesi të informojë në kohë autoritetin kompetent rreth vendimit të tij për të vonuar publikimin e informacionit të privilegjuar.

3. Shtetet anëtare kërkojnë që një emetues, ose një person që vepron në emër të tij ose për llogari të tij, të ketë detyrimin që sa herë që i jep ndonjë lloj informacioni të privilegjuar ndonjë pale të tretë, gjatë ushtrimit normal të profesionit apo detyrave të tij funksionale, sipas parashikimit në nenin 3, germa (a), të bëjë publikim të plotë dhe efikas të atij informacioni, njëkohësisht në rastin e nxjerrjes së qëllimshme të informacionit dhe menjëherë në rast të nxjerrjes jo të qëllimshëm.

Dispozitat e nënparagrafit të parë nuk zbatohen nëse personi që merr informacionin ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit, pavarësisht nëse ky detyrim bazohet në ndonjë ligj, rregullore, në statut apo në kontratë.

Shtetet anëtare kërkojnë që emetuesit, ose personat që veprojnë në emër të tyre ose për llogari të tyre, të hartojnë një listë të personave që punojnë për ta, me kontratë pune ose çdo dokument tjetër, të cilët kanë akses në informacionin e privilegjuar. Emetuesit dhe personat që veprojnë në emër të tyre ose për llogari të tyre, e përditësojnë rregullisht këtë listë dhe ia përcjellin autoritetit kompetent, kurdo që kërkohet prej tij.

4. Personat me përgjegjësi administruese në strukturën e një emetuesi instrumentesh financiare dhe, sipas rastit, personat e lidhur ngushtë me ta, duhet që të paktën të njoftojnë autoritetin kompetent për ekzistencën e transaksioneve të kryera për llogari të tyre, në lidhje me aksionet e emetuesit në fjalë, ose për derivativët ose instrumente të tjera financiare të lidhura me to. Shtetet anëtare sigurojnë se aksesit publik në informacionin që lidhet me transaksione të tilla, të paktën në baza individuale, të vihet në dispozicion sa më shpejt të jetë e mundur.

5. Shtetet anëtare sigurohen që të ekzistojë një rregullore e përshtatshme për të siguruar që personat që prodhojnë apo shpërndajnë kërkime për instrumentet financiare ose për emetuesit e instrumenteve financiare dhe personat që prodhojnë apo shpërndajnë informacione të tjera që rekomandojnë ose sugjerojnë strategji për investimet, të synuara për kanalet e shpërndarjes ose për publikun, të tregojnë kujdesin e arsyeshëm në mënyrë që ky informacion të prezantohet në mënyrë të drejtë dhe të paraqesë interesat e tyre apo të identifikojë konfliktet e interesit të instrumenteve financiare me të cilat lidhet informacioni. Detajet e një rregulloreje të tillë i njoftohen Komisionit.

6. Shtetet anëtare sigurohen që operatorët e tregut të miratojnë dispozita strukturore që synojnë parandalimin dhe zbulimin e praktikave të manipulimit të tregut.

7. Me synimin që të sigurohet përputhshmëria me paragrafët 1 deri në 5, autoriteti kompetent mund të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar që publiku të informohet saktë.

8. Institucionet publike që shpërndajnë statistika të cilat kanë gjasa të kenë një ndikim të konsiderueshëm në tregjet financiare, duhet t'i shpërndajnë ato në mënyrë të drejtë dhe transparente.

9. Shtetet anëtare kërkojnë që çdo person që kryen transaksione të instrumenteve financiare në mënyrë profesionale, të cilët kanë arsye të dyshojnë se një transaksion mund të përbëjë abuzim me informacionin e privilegjuar apo manipulim të tregut, të njoftojë menjëherë organin kompetent.

10. Që të merren parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe që të sigurohet zbatimi i njëtrajtshëm i kësaj direktive, Komisioni, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 17, paragrafi 2, miraton masat zbatuese në lidhje me:

- modalitetet teknike për publikimin e përshtatshëm të informacionit të privilegjuar, sipas parashikimit në paragrafët 1 dhe 3,

- modalitetet teknike për vonesa e publikimit të informacionit të privilegjuar, sipas parashikimit në paragrafin 2,

- modalitetet teknike të ideuara për të favorizuar një qasje të përbashkët në zbatimin e fjalisë së dytë të paragrafit 2,

- kushtet sipas të cilave emetuesit, apo subjektet që veprojnë në emër të tyre, duhet të hartojnë listën e personave që punojnë për ta dhe që kanë akses në informacionin e privilegjuar, sipas parashikimit në paragrafin 3, si dhe kushtet sipas të cilave duhet të përditësohen këto lista,

- kategoritë e personave që kanë detyrimin për të publikuar informacione, sipas parashikimit në paragrafin 4, si dhe karakteristikat e një transaksioni, duke përfshirë përmasat e tij, që e shkaktojnë këtë detyrim, si dhe masat teknike për dhënien e informacionit autoritetit kompetent,

- masat teknike, për kategoritë e ndryshme të personave të përmendur në paragrafin 5, për një paraqitje të drejtë të kërkimit, si dhe informacione të tjera që rekomandojnë strategji investimi, dhe për dhënien e informacionit për interesa të veçanta apo konflikte interesi, siç parashikohet në paragrafin 5. Masa të tilla marrin në konsideratë rregullat, duke përfshirë vet-rregullimin, që rregullojnë profesionin e gazetarit,

- masat teknike që rregullojnë njoftimet ndaj autoritetit kompetent nga personat e përmendur në paragrafin 9.

Neni 7

Kjo Direktivë nuk zbatohet për transaksionet e kryera në ndjekje të politikave monetare, kursit të këmbimit apo të administrimit të borxhit publik nga një shtet anëtar, nga sistemi evropian i bankave qendrore, nga një bankë qendrore kombëtare ose nga çdo organ tjetër i caktuar zyrtarisht apo nga çdo person që vepron në emër të tyre. Shtetet anëtare mund ta shtrijnë këtë përjashtim te shtetet e tyre federata apo te autoritete të ngjashme vendase, në lidhje me administrimin e borxhit të tyre publik.

Neni 8

Ndalimet e parashikuara në këtë direktivë nuk zbatohen për tregtimin e aksioneve vetjake në programet e riblerjes ose për stabilizimin e një instrumenti financiar, përveçse kur ky tregtim kryhet në përputhje me masat zbatuese të miratuara sipas procedurës së përcaktuar në nenit 17, paragrafi 2.

Neni 9

Kjo direktivë zbatohet për çdo instrument financiar të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në të paktën një shtet anëtar, ose atje ku është bërë një kërkesë për pranim për tregtim në një treg të tillë, pavarësisht nga fakti nëse transaksioni në vetvete ndodh në atë treg.

Nenet 2, 3 dhe 4 zbatohen edhe për çdo instrument financiar që nuk është pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në një shtet anëtar, por që vlera e të cilit varet nga një instrument financiar, sipas paragrafit 1.

Neni 6, paragrafi 1 deri në 3 nuk zbatohet për emetuesit që nuk kanë kërkuar ose që instrumentet financiare të të cilëve nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar të ndonjë shteti anëtar.

Neni 10

Çdo shtet anëtar zbaton ndalimet dhe kërkesat e parashikuara në këtë direktivë për:

(a) veprimet e kryera brenda apo jashtë territorit të tij në lidhje me instrumentet financiare të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar që gjendet ose që operon brenda territorit të tij ose për të cilin është bërë një kërkesë për pranim për tregtimin në një treg të tillë;

(b) veprimet e kryera në territorin e tij për instrumente financiare të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në një shtet anëtar ose për të cilin është bërë një kërkesë për pranim për tregtimin në një treg të tillë.

Neni 11

Pa cenuar kompetencat e autoriteteve juridike, çdo shtet anëtar cakton një autoritet kompetent të vetëm administrativ për të siguruar se janë zbatuar dispozitat e miratuara sipas kësaj direktive.

Shtetet anëtare vendosin masa dhe procedura efikase konsultative me pjesëmarrësit në treg në lidhje me ndryshime të mundshme në legjislacionin e brendshëm. Këto masa mund të përfshijnë komitete konsultative brenda çdo autoriteti kompetent, anëtarësia e të cilëve duhet të reflektojë sa më shumë shumëllojshmërinë e pjesëmarrësve në treg, qofshin ata emetues, ofrues të shërbimeve financiare apo konsumatorë.

Neni 12

1. Autoritetit kompetent i jepen të gjitha kompetencat mbikëqyrëse dhe hetimore të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tij. Ai i ushtron këto kompetenca:

- (a) drejtpërsëdrejti; ose
- (b) në bashkëpunim me autoritete të tjera ose me ndërmarrje të tregut; ose
- (c) duke ua deleguar ato këtyre autoriteteve ose ndërmarrjeve të tregut, nën përgjegjësinë e tij; ose
- (d) duke aplikuar tek autoritetet kompetente gjyqësore.

2. Pa cenuar nenin 6, paragrafi 7, kompetencat sipas paragrafit 1 të këtij neni ushtrohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe përfshijnë të paktën të drejtën:

- (a) për të pasur akses në të gjitha dokumentet e çfarëdolloj forme dhe për të marrë një kopje të tyre;
- (b) për të kërkuar informacion nga çdo person, duke përfshirë edhe ata që përfshihen në përcjelljen e urdhrave apo kryerjen e veprimeve përkatëse, si dhe drejtorët e tyre, dhe nëse është e nevojshme, të thërrasin dhe dëgjojnë këta persona;
- (c) për të kryer inspektime në terren;
- (d) për të kërkuar informacione për telefonatat ekzistuese dhe trafikun ekzistues të të dhënave;
- (e) për të kërkuar pushimin e çdo praktike që është në kundërshtim me dispozitat e miratuara në zbatim të kësaj direktive;
- (f) për të pezulluar tregtimin e instrumenteve financiarë përkatës;
- (g) për të kërkuar bllokimin dhe/ose sekuestrimin e aktiveve;
- (h) për të kërkuar ndalimin e përkohshëm të veprimtarisë profesionale.

3. Ky nen nuk cenon dispozitat e legjislacionit të brendshëm, lidhur me ruajtjen e sekretit profesional.

Neni 13

Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional zbatohet për të gjithë personat që punojnë ose kanë punuar më parë për autoritetin kompetent apo për çdo autoritet apo ndërmarrje tregtare, të cilës autoriteti kompetent i ka deleguar kompetencat, duke përfshirë audituesit dhe ekspertët e udhëzuar nga autoriteti

kompetent. Informacioni i mbuluar nga sekreti profesional nuk mund t'i jepet një personi apo autoriteti tjetër përveçse në përputhje me dispozitat e përcaktuara me ligj.

Neni 14

1. Pa cenuar të drejtën e shteteve anëtare për vendosjen e sanksioneve penale, shtetet anëtare sigurojnë, sipas legjislacionit të tyre të brendshëm, se do të merren masat apo sanksionet e duhura administrative ndaj personave përgjegjës, kur nuk veprohet në përputhje me dispozitat e miratuara në zbatimin e kësaj direktive. Shtetet anëtare sigurohen që këto masa të jenë efikase, proporcionale dhe shtrënguese.
2. Në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 17, paragrafi 2, Komisioni harton, për qëllime informimi, një listë masash dhe sanksionesh administrative, sipas paragrafit 1.
3. Shtetet anëtare caktojnë sanksionet që do të zbatohen për mosbashkëpunim në një hetim të mbuluar nga neni 12.
4. Shtetet anëtare i lejojnë autoritetet kompetente të bëjnë publike çdo masë ose sanksion që do të vendoset për shkeljen e dispozitave të miratuara në zbatim të kësaj direktive, me përjashtim të rasteve kur bërja publike e tyre mund të rrezikojë seriozisht tregjet financiare ose të dëmtojë në mënyrë jo proporcionale palët e përfshira.

Neni 15

Shtetet anëtare sigurohen që të ekzistojnë e drejta e apelimit të vendimeve të marra nga autoriteti kompetent.

Neni 16

1. Autoritetet kompetente bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, sa herë që lind nevoja për kryerjen e detyrave të tyre, duke ushtruar kompetencat të tyre të përcaktuara në këtë direktivë apo në legjislacionin e tyre të brendshëm. Autoritetet kompetente u ofrojnë ndihmën e tyre autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare. Në veçanti, ato shkëmbejnë informacion dhe bashkëpunojnë në veprimtari hetimore.
2. Autoritetet kompetente japin menjëherë çdo informacion që u kërkohet për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 1. Kur është e nevojshme, autoritetet kompetente që marrin një kërkesë të tillë, marrin menjëherë masat e nevojshme për të mbledhur informacionin e kërkuar. Nëse autoriteti kompetent që merr kërkesën nuk është në gjendje të japë menjëherë informacionin e kërkuar, ai ia njofton arsyet autoritetit kompetent që ka bërë kërkesën. Informacioni i shkëmbyer në këtë mënyrë mbulohet nga detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional, të cilit i nënshtrohen personat që punojnë apo kanë punuar më parë pranë autoriteteve kompetente që marrin këtë informacion.

Autoritetet kompetente mund të refuzojnë një kërkesë për informacion nëse:

- komunikimi mund të ndikojë negativisht sovranitetin, sigurinë ose politikat publike të shteteve anëtare të cilit i drejtohet,
- është nisur tashmë një proces gjyqësor në lidhje me të njëjtat veprime dhe kundër të njëjtëve persona përpara autoriteteve të shtetit anëtar të cilit i drejtohet, ose

- është dhënë një vendim i formës së prerë në lidhje me këta persona për të njëjtat veprime në shtetin anëtar të cilit i drejtohet.

Në çdo rast të tillë, ata njoftojnë përkatësisht autoritetin kompetent që bën kërkesën, duke dhënë informacion sa më të detajuar mbi ato procese gjyqësore apo mbi vendimin.

Pa cenuar nenin 226 të Traktatit, një autoritet kompetent, kërkesa për informacion e të cilit nuk shqyrtohet brenda një kohe të arsyeshme apo refuzohet, mund ta sjellë këtë rast në vëmendjen e Komitetit të Rregulloreve Evropiane për Titujt, dhe më pas zhvillohen diskutime në mënyrë që të arrihet një zgjidhje e shpejtë dhe efikase.

Pa cenuar detyrimet për të cilat ata janë objekt në proceset gjyqësore sipas të drejtës penale, autoritetet kompetente që marrin informacionin sipas paragrafit 1, mund ta përdorin atë vetëm për ushtrimin e funksioneve të tyre brënda fushës së veprimit të kësaj direktive dhe në kontekstin e procedurave administrative ose gjyqësore të lidhura veçanërisht me ushtrimin e këtyre funksioneve. Megjithatë, nëse miratohet nga autoriteti kompetent që përcjell informacionin, autoriteti që merr informacionin mund ta përdorë atë për qëllime të tjera ose ta përcjellë tek autoritetet kompetente të shteteve të tjera.

3. Kur një autoritet kompetent është i bindur që ndërmerren, apo janë ndërmarrë veprime në kundërshtim me dispozitat e kësaj direktive, brenda territorit të një shteti tjetër anëtar apo që këto veprime po cenojnë instrumentet financiare të tregtuara në një treg të rregulluar që gjendet në një shtet tjetër anëtar, ai njofton në mënyrë sa më specifike autoritetin kompetent të shtetit tjetër anëtar për këtë fakt. Autoriteti kompetent i shtetit tjetër anëtar merr masat e duhura. Ai informon autoritetin kompetent njoftues për rezultatin dhe, për sa është e mundur, edhe për zhvillimet e rëndësishme të përkohshme. Ky paragraf nuk cenon kompetencat e autoritetit kompetent që ka përcjellë informacionin. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare të ndryshme që janë kompetente për qëllimet e nenit 10, konsultohen me njëri-tjetrin për vazhdimësinë e propozuar të veprimit të tyre.

4. Autoriteti kompetent i një shteti anëtar mund të kërkojë që të kryhet një hetim nga autoriteti kompetent i një tjetër shteti anëtar, në territorin e këtij të fundit.

Gjithashtu, mund të kërkojë edhe që anëtarët e personelit të tij të lejohen të shoqërojnë personelin e autoritetit kompetent të shtetit tjetër anëtar gjatë kryerjes së hetimit.

Megjithatë, hetimi i nënshtrohet kontrollit të përgjithshëm nga ana e shtetit anëtar në territorin e të cilit kryhet hetimi.

Autoritetet kompetente mund të refuzojnë të veprojnë në përgjigje të ndonjë kërkesë për hetim, sipas nënparagrafit të parë, ose kërkesës që personeli i tij të shoqërohet nga personeli i autoritetit kompetent të një shteti tjetër anëtar, siç parashikohet në nënparagrafin e dytë, kur ky hetim mund të ndikojë negativisht në sovranitetin, sigurinë apo politikat publike të shtetit që i drejtohet ose kur kanë nisur më parë procedura gjyqësore në lidhje me të njëjtat veprimet dhe kundër të njëjtëve persona përpara autoriteteve të shtetit të cilit i drejtohet ose kur është dhënë tashmë një vendim i formës së prerë për të njëjtët persona dhe për të njëjtat vepra në shtetin të cilit i drejtohet. Në çdo rast të tillë, ata njoftojnë përkatësisht autoritetin kompetent që bën kërkesën, duke dhënë informacion sa më të detajuar mbi ato procese gjyqësore apo mbi vendimin.

Pa cenuar dispozitat e nenit 226 të Traktatit, në rast se nuk veprohet brenda një afati kohor të arsyeshëm ose në rast refuzimi kur një autoritet kompetent bën kërkesë për të hapur një hetim apo kërkon autorizim që zyrtarët e tij të shoqërojnë ata të autoritetit kompetent të shtetit tjetër anëtar, ky

mosrespektim mund të jetë në vëmendjen e Komitetit Evropian të Rregulloreve për Titujt, i cili do të zhvillojë diskutime në mënyrë që të arrihet një zgjidhje e shpejtë dhe efikase.

5. Në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 17, paragrafi 2, Komisioni miraton masat zbatuese për procedurat e shkëmbimit të informacionit dhe inspektimet ndërkufitare, sipas këtij neni.

Neni 17

1. Komisioni ndihmohet nga Komiteti Evropian i Titujve i krijuar me Vendimin 2001/528/KE (në vijim referuar si "Komiteti").

2. Në rastet kur referohet ky paragraf, zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij, me kusht që masat zbatuese të miratuara në përputhje me këtë procedurë të mos ndryshojnë dispozitat thelbësore të kësaj direktive.

Periudha e përcaktuar në nenin 5 paragrafi 6 të Vendimit 1999/468/KE është tre muaj.

3. Komiteti miraton vetë rregulloren e tij të brendshme.

4. Pa cenuar masat zbatuese të miratuara më parë, me përfundimin e periudhës prej katër vjetësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, pezullohet zbatimi i dispozitave të saj që kërkojnë miratimin e normave teknike dhe vendimeve në përputhje me paragrafin 2. Me propozim të Komisionit, Parlamenti Evropian dhe Këshilli mund të ripërtërijnë dispozitat në fjalë, sipas procedurës së parashikuar në nenin 251 të Traktatit dhe në këtë rast, ato procedojnë me këtë rishikim përpara përfundimit të periudhës së përmendur më lart.

Neni 18

Deri më 12 Tetor 2004, shtetet anëtare miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me këtë direktivë. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë.

Shtetet anëtare, në miratimin e këtyre masave, i referohen direktivës ose i shoqërojnë ato me një referencë në rastin e botimit zyrtar të tyre. Mënyra sesi do të bëhet kjo referencë përcaktohet nga shtetet anëtare.

Neni 19

Neni 11 nuk cenon mundësinë që një shtet anëtar të marrë masa të veçanta ligjore dhe administrative për territoret jashtë shteteve evropiane për të cilat ai shtet anëtar mban përgjegjësinë e marrëdhënieve të jashtme.

Neni 20

Direktiva 89/592/KEE dhe neni 68, paragrafi 1 dhe neni 81, paragrafi 1 i Direktivës 2001/34/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 28 majit 2001 për pranimin e titujve në bursë dhe për informacionin që do të publikohet për ato tituj ⁽¹⁰⁾ shfuqizohet me efekt që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj direktive.

Neni 21

Kjo direktivë hyn në fuqi në datën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Ba shkimit Evropian.

Neni 22

Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 28 janar 2003.

Për parlamentin

Presidenti

P. Cox

Për Këshillin

Presidenti

G. Papandreou

(1) *Gazeta Zyrtare C 240 E*, 28.8.2001, f. 265.

(2) *Gazeta Zyrtare C 80*, 3.4.2002, f. 61.

(3) *Gazeta Zyrtare C 24*, 26.1.2002, f. 8.

(4) Opinioni i Parlamentit Evropian i 14 marsit 2002 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit i 19 korrikut 2002 (*Gazeta Zyrtare C 228 E*, 25.9.2002, f. 19) dhe Vendimi i Parlamentit Evropian i 24 tetorit 2002 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare).

(5) *Gazeta Zyrtare L 184*, 17.7.1999, f. 23.

(6) *Gazeta Zyrtare L 334*, 18.11.1989, f. 30.

(7) *Gazeta Zyrtare L 281*, 23.11.1995, f. 31.

(8) *Gazeta Zyrtare L 191*, 13.7.2001, f. 45.

(9) *Gazeta Zyrtare L 141*, 11.6.1993, f. 27. Direktiva e ndryshuar së fundmi me Direktivën 2000/64/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 290*, 17.11.2000, f. 27).

(10) *Gazeta Zyrtare L 184*, 6.7.2001, f. 1.